

Nr. 5 Prot.

Dt. 06.01.2023

KOMITETI SHTETËROR PËR KULTET

**RAPORTI VJETOR
I PUNËS**



VITI 2022

Bulevardi Zogu I, Nd. 9, H. 4, Ap. 7, 1016, Tiranë; Tel +355042227131;
e-mail: komitetishk@kshk.gov.al

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive

Akronime

Hyrje

Kapitulli I

Faqe 4 - 9

- ***Kuadri Legjislativ i së Drejtës së Lirisë së Fesë s Besimit në Shqipëri.***
- ***Kuadri Institucional Fetar për Vitin 2022.***
- ***Kuadri Ligjor Mbi Të Cilin Bazohet Veprimtaria E Kshk Dhe Organizimi I Tij.***

Kapitulli II

Faqe 9 –12

- ***Drejtimet Kryesore Për Realizimin E Objektivave Gjatë Vitit 2022.***
- ***Kalendari i Aktiviteteve Të Zhvilluara Gjatë Vitit 2022.***
- ***Vlersimi nga Organizmat ndërkomtare.***
- ***Bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe ato lokale.***
- ***Nevoja për përmirësim***

Kapitulli III

Faqe 12 – 14

- ***Mbyllja E Projektit: “Mbi Marrëdhëniet Shtet – Fe Në Nivel Lokal”***

Kapitulli IV

Faqe 14 - 21

Buxheti Për Vitin 2022:

- ***Zërat Ekonomikë Dhe Realizimet E Tyre.***
- ***Prokurimet Për Blerjet E Vogla.***
- ***Konkluzione.***

AKRONIME

- **KM** – *Këshilli i Ministrave*
- **KSHK** – *Komiteti Shtetëror për Kultet*
- **BF** – *Bashkësi Fetare*
- **KMSH** – *Komuniteti Mysliman i Shqipërisë*
- **KOASH** – *Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë*
- **KKSH** – *Kisha Katolike në Shqipëri*
- **KBB** – *Kryegjyshata Botërore Bektashiane*
- **VUSH** – *Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë*
- **VKM** – *Vendim i Këshillit të Ministrave*
- **OJF** - *Organizatat Jofitimprurëse*
- **PBA** - *Programi Buxhetor Afatmesëm*

Bulevardi Zogu I, Nd. 9, H. 4, Ap. 7, 1016, Tiranë; Tel +355042227131;
e-mail: komitetishk@kshk.gov.al

HJRJE

Komiteti Shtetëror për Kultet, si një institucion qendror, në varësi të Kryeministrit, vepron në bazë të VKM-së Nr. 459, datë 23.09.1999, i ndryshuar dhe, në ushtrimin e detyrës së tij, i nënshtrohet zbatimit të së drejtës kushtetuese të lirisë së fesë e besimit dhe të konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, në këtë fushë. Mbarëvajtja e institucionit është bërë e mundur në sajë të bashkëpunimit shumëpalësh me Bashkësitë fetare, me OJF-të me karakter fetar dhe me institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor. Gjatë vitit 2022, veprimtaria e KSHK-së është udhëhequr nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 (VKM nr. 536, datë 29.7.2022 "Për miratimin e projektdokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025), ku janë të përcaktuara qartë objektivat, drejtimit, mënyrat e realizimit të tyre, shoqëruar me shpenzimet përkatëse të alokuara. Institucioni është treguar i kujdesshëm që të forcojë klimën e respektit për besimin fetar në vend, si një faktor për fuqizimin e bashkëjetesës fetare tradicionale dhe si vlerësim për kontributin shoqëror-arsimor-shëndetësor të bashkësive dhe organizatave fetare në jetën shqiptare. Me një vëmendje të veçantë në sigurimin e së drejtës së besimit, duke i konsideruar fetë si kontribues dhe partnerë të fuqishëm në përhapjen e vlerave morale dhe zgjidhjen e problematikave sociale, KSHK është angazhuar totalisht për ngritjen e nivelit koordinues mes shtetit dhe feve.

KAPITULLI I

Kuadri legjislativ i së drejtës së lirisë së fesë e besimit në Shqipëri

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, me nenet 10 dhe 24, garanton të drejtën e lirisë së besimit dhe siguron ndarjen dhe pavarësinë e shtetit nga feja. Në to shprehimisht thuhet:

Neni 10

1. Në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare. 2. Shteti është asnjans në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike. 3. Shteti njeh barazinë e bashkësive fetare. 4. Shteti dhe bashkësitë fetare respektojnë në mënyrë të ndërsjelltë pavarësinë

Bulevardi Zogu I, Nd. 9, H. 4, Ap. 7, 1016, Tiranë; Tel +355042227131;
e-mail: komitetishk@kshk.gov.al

e shqiptarit dhe bashkëpunojnë në të mirë të secilit dhe të të gjithëve. 5. Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen në Kuvend. 6. Bashkësitë fetare janë persona juridikë. Ato kanë pavarësi në administrimin e pasurive të tyre sipas parimeve, rregullave dhe kanoneve të tyre, për sa nuk cenohen interesat e të tretëve.

Neni 24

1. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar. 2. Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve. 3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohej të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.

Njëkohësisht, ligjet mbështetëse në këtë fushë, rrisin efektivitetin dhe bëhen provë e fuqishme e zbatimit në jetë të këtyre të drejtave. Këtë e dëshmon panorama e larmishme fetare e vendit tonë, ku ndërthuren fe dhe tradita fetare të ndryshme, dhe ku, krahas 5 komuniteteve kryesore fetare, të cilat kanë ratifikuar marrëveshje reciproke me Qeverinë Shqiptare, ushtrojnë misionin e tyre, edhe “besimet e vogla”, të përfaqësuara nga dhjetëra fondacione, organizata apo shoqata.

E drejta e lirisë apo besimit fetar, rrjedh gjithashtu, nga angazhimet në nivel ndërkombëtar që shteti shqiptar ka pranuar dhe zbatuar. Shqipëria ka ratifikuar 9 traktate ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, në respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtës së fesë apo besimit krahas pjesëmarrjes dhe rolit të saj aktiv në Këshillin Evropian.

Rezultatet e arritura në këtë drejtim, janë bërë objekt i vlerësimit të lartë nga ana e organizmave ndërkombëtare të interesuar në këtë fushë. Këtë e dëshmojnë deklaratat nga takimet dhe raportet e ndryshme të përfaqësuesve ndërkombëtarë, ku evidencohet roli pozitiv dhe inkurajues i shtetit shqiptar për ushtrimin dhe mbrojtjen e lirisë së fesë apo besimit, dëshmi e të cilës është mungesa e rasteve të denoncuara të diskriminimit për shkak të përkatësisë fetare apo e problemeve sistematike dhe thelbësore në këtë fushë, edhe gjatë vitit 2022.

Aktualisht, përveç 5 bashkësive fetare që kanë nënshkruar marrëveshje specifike me Qeverinë shqiptare, ushtrojnë aktivitetin e tyre dhe shumë besime të tjera, që veprojnë në formën e shoqatave/organizmave me karakter humanitaro – fetar. OJF-të udhëhiqen nga legjislacioni kryesor përkatës ekzistues, i cili përfshin, por nuk kufizohet, me Kushtetutën Shqiptare, të ndryshuar, Ligjin nr. 8788, datë 7.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar dhe Ligji nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”. OJF-të e huaja ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri në përputhje me Kushtetutën shqiptare dhe legjislacionin e organizatave jofitimprurëse.

Kuadri institucional fetar për vitin 2022

Bashkësitë fetare si vijon: 1) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, 2) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, 3) Kisha Katolike në Shqipëri, 4) Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe 5) Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë, kanë nënshkruar marrëveshjeve për marrëdhënie të ndërsjella me Këshillin e Ministrave. Këto të fundit që janë ratifikuar në parlament me ligjet përkatëse: Ligji nr. 8902, datë 23/05/2002, Ligji nr. 10056, datë 22/01/2009, Ligji nr. 10057, datë 22/01/2009, Ligji nr. 10058, datë 22/01/2009, ligji nr. 10394, datë 10/03/2011, vendosin kornizën ligjore mbi të cilën bazohen raportet mes shtetit dhe bashkësive fetare. Njëkohësisht ligjet e mësipërme, u krijojnë komuniteteve fetare, kushtet që të ushtrojnë lirisht të drejtën e tyre të besimit, edukimit fetar, aktiviteteve, shërbesave etj. Katër prej këtyre bashkësive, që prej vitit 2009 asistohen financiarisht nga shteti shqiptar për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve laikë të administratës dhe arsimit, në zbatim të ligjit Nr. 10140, datë 15.05.2009 “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”. Shuma e akorduar nga Këshilli i Ministrave ishte në masën prej 113.000.000 lekësh, e shpërndarë me VKM-në nr. 340, datë 26.05.2022.

Krahas bashkësive fetare të sipërpërmendura, në Republikën e Shqipërisë ushtrojnë të drejtën kushtetuese të lirisë së fesë, besime të tjera, siç janë: Baha’i, Dëshmitarët e Jehovait, Kisha e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, Xhemati Ahmaddya, e shumë të tjerë, që veprojnë nëpërmjet shoqatave/ organizatave/ fondacioneve me karakter humanitaro – fetar, të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, në zbatim të ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001, “Për Organizatat Jofitimprurëse”.

Kuadri ligjor mbi të cilin bazohet veprimtaria e KSHK dhe organizimi i tij

Komiteti Shtetëror për Kultet u krijua me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 459, datë 23.09.1999 , “Për krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet”, si vazhdë e Sekretariatit mbi fenë dhe shprehje e qartë e ndjeshmërisë që qeveria shqiptare tregon për rolin e fesë në shoqëri. Vendimi i sipërpërmendur u pasua me ndryshime në varësinë dhe organikën e KSHK-së, si vijon: me VKM-në Nr. 128, datë 11.03.2004, me VKM Nr. 666, datë 26.10.2005, me VKM Nr. 777, datë 14.12.2005, me VKM Nr. 344, datë 07.06.2006, me Urdhrin Nr. 186, datë 03.08.2006, me VKM 1029, datë 27.11.2003 dhe me VKM Nr. 602, datë 10.09.2014, pa ndryshuar natyrën e tij si hallkë rregullatore mes Shtetit dhe feve.

Bulevardi Zogu I, Nd. 9, H. 4, Ap. 7, 1016, Tiranë; Tel +355042227131;
e-mail: komitetishk@kshk.gov.al

Komiteti Shtetëror për Kultet ka si funksion kryesor: *“Krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet për të ndihmuar në krijimin, ndryshimin dhe shuarjen e marrëdhënieve ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare, që kanë objekt dhe ndjekin qëllime besimi dhe ndërgjegje, sipas ligjit në Republikën e Shqipërisë”*.


- Ky institucion synon dhe ka si përparësi të veprimtarisë së vet, punën për:
- Zbatimin e detyrimeve kushtetuese;
 - Plotësimin e kuadrit ligjor mbi marrëdhëniet e shtetit me fenë;
 - Zbutjen dhe shuarjen e konflikteve që mund të çënojnë harmoninë ndërfetare në vend. Përgjegjësitë kryesore të KSHK-së mund të përmbliidhen si vijon:
 - Bashkërendimin e marrëdhënieve me komunitetet fetare, shoqatat, fondacionet fetare ose humanitare-fetare;
 - Garantimin e lirisë së besimit dhe për zhvillimin, bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe tolerancën ndërfetare në Shqipëri, duke qenë asnjnjës në çështjet e besimit dhe duke njohur barazinë e bashkësive fetare dhe respektuar pavarësinë e tyre;
 - Shprehjen e mendimit të tij Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, lidhur me planin mësimor, programet dhe tekstet e pjesës jolaike, për kërkesat e paraqitura për hapjen e institucioneve arsimore jopublike, institucioneve arsimore plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare dhe në bashkëpunim me atë institucion, në varësi të ndarjes administrative territoriale, të interesave të përbashkëta ekonomike dhe të traditës historike e fetare;
 - Interesimin për ruajtjen e vlerave të objekteve të kultit në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës¹ dhe me komunitetet fetare;
 - Paraqitjen e mendimit të tij Ministrisë së Financave, lidhur me hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të mallrave me karakter fetar për komunitetet fetare dhe për përjashtimin e tyre nga taksat doganore, në përputhje me ligjet në fuqi;
 - Vendosjen dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet homologe të vendeve të tjera e të diasporës, në funksion të promovimit të bashkëjetesës fetare në vend.

¹ Aktualisht, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore – bashkim i Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik. IKTK – me ligjin 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Organizimi I KShK-Së

Në bazë të VKM - së Nr. 186, datë 03.08.2006, Komiteti Shtetëror për Kultet funksionon si një trup i vetëm, në përbërjen e të cilit përfshihen: 1 Kryetar, 5 Anëtarë, 3 Specialistë dhe një punonjës mbështetës(shofer).

ORGANIGRAMA



Përveç detyrave të paraqitura në organigramën e mësipërme, Kryetari i KSHK-së bën ndarje detyrash sipas përgjegjësi dhe nevojave institucionale, në përmbushje të detyrimeve ligjore. Titullari, për shkak të organikës së thjeshtuar, edhe gjatë vitit 2022, ka qenë përgjegjës për ndjekjen e plotësimit të objektivave specifike për secilin punonjës dhe ka bërë vlerësimin e performancës për ta, gjatë gjithë harkut kohor të vitit 2022. Ky proces i nështrohet legjislacionit në fuqi për administratën publike dhe menaxhimin e kontrollin financiar në njësitë qendrore publike. Struktura e thjeshtë organike krijon kushtet për një kontroll të brendshëm efikas dhe të

vazhdueshëm, gjë që ndikon pozitivisht në ritmet e punës së KSHK-së dhe në mungesën e hambjeve kohore që mund të shkaktoheshin nga burokracia brenda institucionit.

KAPITULLI II

Drejtimit kryesore për realizimin e objektivave gjatë vitit 2022

Komiteti Shtetëror për Kultet funksionon në zbatim të VKM-së nr. 459, datë 23.09.1999, i ndryshuar me VKM nr. 128, datë 11.03.2004. Pika 1, që shprehimisht thotë: “...krijimin e KSHK për të ndihmuar në krijimin, ndryshimin dhe shuarjen e marrëdhënieve ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare, që kanë objekt dhe ndjekin qëllime besimi dhe ndërgjegje, sipas ligjit në Republikën e Shqipërisë ...”, përcakton rolin kryesor të tij.

KSHK-ja, gjatë vitit 2022, ka vijuar të kryej rolin bashkërendues, ndërmjet shtetit dhe organizmave fetarë në vend. Kjo është realizuar duke u mbështetur në parimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas neneve 10 dhe 24 që garantojnë të drejtat dhe liritë e besimit e të ndërgjegjes, si dhe të legjislacionit mbi organizmat fetarë në fuqi.

Komiteti Shtetëror për Kultet, si çdo institucion i administratës shtetërore, përcakton objektivat afatshkurtër dhe afatmesëm, për përmbushjen e misionit të tij. Këto objektiva reflektohen dhe dokumentohen në Planet specifike të punës të punonjësve, në Planin Vjetor të Punës dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm, të cilat përpunohen nga të gjithë punonjsit dhe miratohet nga titullari.

Kalendari i aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit 2022

Kalendari i aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit 2022 është i ndarë në dy pjesë: në të brendshëm dhe në të jashtëm.

1. Në kalendarin e aktiviteteve të organizuar brënda vendit, Komiteti Shtetëror për Kultet ka zhvilluar në mënyrë periodike e të vazhdueshme, takime me përfaqësues të komuniteteve

fetare dhe ka ndjekur një sërë aktivitetesh, konferencash, seminaresh e simpoziumesh shkencore të organizuara prej tyre në vend, ndër më të rëndësishmet po përmendim:

- Ceremonia e emërimit të Imzot Arjan Dodaj, në krye të Arqidioqezës Metropolitane Tiranë-Durrës;
 - Ceremonia e nderimit të Imzot Angelo Massafra “Qytetar Nderi i Qarkut Shkodër”;
 - Takimi i 8-të të procesit të Stambollit, me temë “10 vjetori i Rezolutës së KDNJ-së 16/18: Looking back and moving forward”, të organizuar nga Misioni i Pakistanit, në Gjenevë;
 - Konferenca Ndërkombëtare dhe Ndërfetare “Vëllazëria në Humanizëm”, organizuar nga Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë këtu në Tiranë;
 - Konferenca “Krishtërimi Ortodoks në Shqipëri, në 20 shekuj”, organizuar nga Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë;
 - Konferenca “Kultura midis bashkësive fetare”, në kuadër të projektit të mbështetur nga Bashkimi Europian, INTERFIDECRT (nxitja e dialogut ndërfetar dhe rritja e turizmit fetar ndërkufitar);
 - Konferenca Jubilare “Bektashizmi dhe Paravësia”, me rastin e 110-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë;
 - Konferenca shkencore “Globalizmi dhe Paqja”, me rastin e marrjes së Titullit të Paqes, së Kryegjyshit Botëror, Edmond Brahimaj;
 - Pjesmarrja në Aktivitetin e Organizuar në Malin e Tomorrit, në pelegrinazhin e përvitëshëm të organizuar nga Kryegjyshata Botrore Bektashiane;
 - Takime të Kryetarit të Komitetit Shtetëror për Kultet dhe Anëtarëve, me Krerët lokalë fetarë;
 - Takime të Kryetarit të Komitetit Shtetëror për Kultet dhe Anëtarëve, me përfaqësues të pushtetit vendor dhe klerikët lokal;
 - Vizita të Kryetarit të Komitetit Shtetëror për Kultet dhe Anëtarëve, nëpër shkollat e bashkësive fetare, si dhe në objektet fetare me status monument kulture (KMSH, KOASH, KKSH, KBB, VUSH); etj.
2. Ndërsa në aktivitetet e organizuara jashtë shtetit, në kuadër të raportimit dhe të promovimit të vlerave të harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfetare, në arenën ndërkombëtare, ndër të tjera mund të përmendim:

Bulevardi Zogu I, Nd. 9, H. 4, Ap. 7, 1016, Tiranë; Tel +355042227131;
e-mail: komitetishk@kshk.gov.al

- Pjesëmarrja e Kryetarit në kuadër të Takimeve dypalëshe BE – Shqipëri, për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” të organizuar nga Komisioni Europian më 24-25 nëntor në Bruksel, Belgjikë;
- Takimi mbi Çështjet Fetare ndërmjet Vendeve të Rajonit të Ballkanit, zhvilluar më 12-13 prill 2022, në Shkup, Maqedoni e Veriut;
- Simpoziumi me temë: “Harmonia fetare dhe toleranca, një vlerë e shtuar shqiptare në Europë”, organizuar nga konsullata jonë e nderit më 13-16 maj 2022, në North Rhine-Ëestphalia (NRË) Gjermani;
- Në frymën e bashkëpunimit ndërkombëtar janë zhvilluar një sër takimesh me ambasada dhe organizma të ndryshme ketu në vend, që trajtojnë të drejtat e njeriut dhe lirinë e besimit dhe të fesë, të interesuara për promovimin e harmonisë fetare shqiptare.

Vlerësimi nga Organizmat ndërkombëtare.

Në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe për liritë e besimit dhe të fesë Komiteti Shtetëror për Kultet, bën raportime periodike vjetore, ku ndër të tjera ka marrë edhe vlerësime nga Organizmat Ndërkombëtar për punën e kryer nga institucioni ynë. Në këto raporte si ai i DASH-it ; OKB-së ; i OSBE-së dhe i Komisionit Europian vlerësohet roli i KSHK-së, nën autoritetin e Kryeministrit, si institucion shumë i rëndësishëm që bashkërendon i marrëdhëniet ndërmjet qeverisë dhe të gjitha organizmave me karakter fetar në vend.

Në Progres-Raportin e vitit 2022 të Komisionit Europian është vlerësuar mbështetja e qeverisë në mbështetjen financiare që akordon për bashkësitë fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me KM si një instrument në drejtim të përforsimit të lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.

Bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe ato lokale

Komiteti Shtetëror për Kultet ka vijuar bashkëpunimin me institucionet qendrore dhe ato lokale, duke dhënë mendimet dhe kontributin e tij, ku ndër më kryesoret kanë qenë në lidhje me:

- Legalizimin e objekteve të kultit të ndërtuara para dhe pas vitit 1991;
- Ndryshimet në vendimin “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit 2021-2025 dhe planit të veprimit 2021-2023”, me qëllim eliminimin e keqkuptimit në përdorimin e termave fetarë;
- Përgatitjen e raportit “E drejta për lirinë e ndërgjegjies dhe vlerësimin fetar”, në kuadër të zbatimit të Konventës për të Drejtat e Njeriut të OKB-së;

- Pjesëmarrjen dhe dhënien e mendimit në Grupin e Punës mbi situatën e krimeve okulte në Shqipëri të organizuar nga Ministria e Brëndshme;
- Hartimin dhe përfundimin e Raportit mbi Vlerësimin e Rrezikut për Financimin e Terrorizmit në Sektorin e OJF-ve në Shqipëri;
- Shprehjen e mendimit të tij dhe të bashkësive fetare, mbi projektvendimin që po hartohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për arsimin e lartë jolaik dhe specifikat e funksionimit të institucioneve të tij.

Nevoja për përmirësim

Në zbatim të detyrës së tij ligjore të shprehur në pikën 2/2 dhe 2/5 të VKM –së nr. 459, datë 23/09/1999, “Për krijimin e KSHK”, shprehimisht: “*Negocion për përgatitjen e marrëveshjeve ndërmjet përfaqësuesve të bashkësive fetare dhe Këshillit të Ministrave*” dhe “*Bashkëpunon me bashkësitë fetare për përgatitjen e projektligjeve dhe akteve nënligjore, që kanë të bëjnë me kultet fetare*”.

Duke patur parasysh kërkesat e vazhdueshme të bashkësive fetare për rishikim të marrëveshjeve të ratifikuara në ligje nr. 10056, nr. 10057 dhe nr. 10058, datë 22.01.2009, Komiteti Shtetëror për Kultet është angazhuar në këtë drejtim duke qenë se disa aspekte juridiko – fiskale të këtyre marrëveshjeve paraqesin paqartësi në zbatim nga institucionet shtetërore për rrjedhojë rishikimi bëhet i nevojshëm. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2022, janë zhvilluar takime konsultuese me bashkësitë fetare. Në këto takime është mbledhur informacion mbi kërkesat/propozimet e bashkësive fetare për të cilat do të adresohen në të ardhmen në institucionet e linjës. Një tjetër problematikë të adresuar prej BF është çështja e kthimit të pronave që u përkasin grupeve fetare, të sekuestruara nga shteti gjatë regjimit komunist, ku sipas pretendimeve të BF mbetet një çështje akoma e pazgjidhur.

KAPITULLI III

Mbyllja e projektit: “Mbi marrëdhëniet shtet – fe në nivel lokal”

Projekti studimor me temë: “*Marrëdhëniet shtet – fe në nivel lokal*”, u ndërmorr me iniciativën e Komitetit Shtetëror për Kultet, nisur nga indiciet e mbledhura në takimet e shumta me

Bulevardi Zogu I, Nd. 9, H. 4, Ap. 7, 1016, Tiranë; Tel +355042227131;
e-mail: komitetishk@kshk.gov.al

përfaqësues të ndryshëm lokalë. Një studim i tillë që bëhej për herë të parë në vendin tonë, u drejtua nga një institucion shtetëror dhe synoi të pasqyronte gjendjen aktuale të marrëdhënieve, pa asnjë influencë me karakter politik apo fetar.

Qëllimi i këtij projekti ishte:

- krijimi (aty ku nuk ekziston), nxitja dhe forcimi i bashkëpunimit mes aktorëve të ndryshëm shoqërorë, qofshin ata shtetërorë apo fetarë, për zgjidhjen e plagëve sociale, për mbështetjen e të rinjve në nismat për një perspektivë optimiste jete, për ruajtjen dhe promovimin e vlerave historike të bashkëjetesës fetare;
- pasqyrimi i problematikave me të cilat përballen përfaqësuesit e sipërpërmendur, në realitetin lokal, duke përcjellë shqetësimet dhe dëshirat për një përmirësim të situatës ndër-relacionale;
- shkalla e njohurive legislative dhe informacioni në fushën e fesë, si nga përfaqësuesit shtetërorë, ashtu edhe nga ata fetarë, me qëllimin final të mirinformimit të tyre; kjo për të siguruar e garantuar ushtrimin e së drejtës së fesë e besimit, si një e drejtë universale, themelore njerëzore.

Përgjatë viteve 2019 - 2022, projekti u fokusua në të gjithë territorin e Shqipërisë. Ai u zhvillua nëpërmjet një rrjeti kapilar, që përfshiu ndarjet administrative nga më të mëdhatë (qarqet, bashkitë, prefekturat) tek më të voglat (njësitë administrative, etj.), për të patur një pasqyrë reale të marrëdhënieve shtet - fe në nivel lokal. Nëpërmjet intervistave direkte, të strukturuar dhe semi-strukturuar, atyre iu paraqitën pyetsorë të përgatitur paraprakisht me rigorozitet nga stafi i Komitetit Shtetëror për Kultet dhe u mblodhën informacione të vlefshme. Intervistat e semi-strukturuar u pasuruan me komente të lira nga të intervistuarit, të cilat janë përfshirë në vlerësimet e KSHK-së.

Duke iu përmbajtur idesë themelore mbi të cilën Komiteti Shtetëror për Kultet inicioi Projektin mbi marrëdhëniet mes shtetit dhe feve në nivel lokal, ndryshimet, në formën e disa shtesave, u diktuan nga nevoja që pyetsori të ishte sa më i kuptueshëm, pasi mungesa e tyre mund të krijonte mosdhënie shpjegimesh nga të intervistuarit. Qëllimi kryesor ishte marrja e informacionit sa më i saktë e sa më i detajuar, duke patur parasysh karakteristikat e panoramës fetare të zonave të Shqipërisë së Mesme.

U vu re se njohuritë mbi bazën ligjore nuk mishëronin nivelin më të lartë të pritshmërive, gjë që u reflektua jo vetëm te punonjësit e administratës, por edhe te përfaqësuesit e bashkësive fetare. Kishte mungesa të theksuara të njohjes së Kushtetutës, të marrëveshjeve të nënshkuara ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare, si dhe të ligjit nr. 8788, dt. 07.05.2011 "Për Organizatat Jofitimprurëse", mungesa të cilat nuk të ishin kaq të dukshme, pasi baza ligjore konsiderohet se njihet mirë nga të dyja palët që operojnë në çështjet fetare.

Gjate plotësimit të pyetësorëve u vu re se, përfaqësuesit e institucioneve vendore, shoqatave, bashkësive fetare, nuk kishin informacionet e nevojshme, as mbi funksionin dhe rolin që luan Komiteti Shtetëror për Kultet, si institucioni shtetëror që bashkërendon marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe fesë.

Po ashtu, pushteti vendor dhe bashkësitë fetare rezultuan të mos kenë njohuri të sakta, as mbi numrin e shoqatave/bashkësive fetare që veprojnë në zonat e tyre, megjithëse bashkëpunimi ndërmjet të dyja palëve ka qenë në nivelin e duhur. Për këtë arsye, shihet e rekomandueshme që ata të jenë më shumë të interesuar dhe të vlerësojnë në mënyrën e duhur shërbimet që ofron secila palë.

Lëvizjet e shpeshta të punonjësve të administratës shtetërore ndikojnë në dobësimin e marrëdhënieve ndërmjet pushtetit vendor dhe bashkësive/shoqatave fetare.

Shumë pozitiv është fakti që bashkësitë fetare/shoqatat nuk ndihen të diskriminuara e as të favorizuara nga institucionet shtetërore.

Nisur nga sa më sipër, Komiteti Shtetëror për Kultet ka përgatitur një material ku janë të përfshira Kushtetuta e Shqipërisë, marrëveshjet e nënshkruara me bashkësitë fetare, Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ligji për OJF-të, baza ligjore e Komitetit Shtetëror për Kultet etj.. Kjo do të kontribuojë në një njohje më të mirë të legjislacionit dhe të institucioneve shtetërore, si dhe në forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndër-institucionale.

Gjithashtu, sugjerojmë që:

- Në institucionet shtetërore të ketë një punonjës të posaçëm, i cili të merret me trajtimin e çështjeve fetare, por dhe të shërbejë si pikë kontakti me Komitetin Shtetëror për Kultet.

KAPITULLI IV

Buxheti për vitin 2022

Komiteti Shtetëror për Kultet është një institucion shtetëror dhe si i tillë, i nënshtrohet legjislacionit në fuqi për administratën publike. Duke qenë një institucion buxhetor dhe duke përfituar fonde nga buxheti i shtetit, ai harton politikat e tij në linjë me politikat qeveritare mbi fenë, duke i alokuar fondet përkatëse për realizimin e objektivave të parashikuara.

Për këtë qëllim dhe në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 115/2021, “Për Buxhetin e vitit

2022”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, dhe të Udhëzimit plotësues Nr. 1, datë 10.1.2022, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, të gjithë komponentët e PBA 2023-2025 janë hartuar që të harmonizojnë politikat/objektivat e Komitetit Shtetëror për Kultet, me shpërndarjen buxhetore për realizimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 10140, datë 15.05.2009 “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”, gjatë vitit 2022 janë shqyrtuar kërkesat e paraqitura prej bashkësive fetare. Shuma e akorduar nga Këshilli i Ministrave ishte në masën prej 113.000.000 lekësh, e shpërndarë sipas VKM Nr. 340, datë 26.05.2022.

Zërat Ekonomikë Dhe Realizimi i Tyre

Në zbatim të politikës së programit “Mbështetje për Kultet Fetare” si një mjet për garantimin e një mjedisi ku, çdo bashkësi fetare, të shprehë dhe të praktikojë lirisht të drejtën kushtetuese të besimit dhe duke iu përmbajtur tavaneve buxhetore të miratuara me VKM Nr. 536, datë 29.07.2022 “Për miratimin e projektdokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025” është bërë shpërndarja e fondeve buxhetore sipas artikujve ekonomikë, për secilin produkt (tabelat e mëposhtme).

Përdorimi i fondeve buxhetore e detyron institucionin të zbatojë me përpikmëri ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, duke monitoruar vazhdimisht gjatë harkut vjetor, përputhshmërinë e shpenzimeve institucionale me shkallën e realizimit të objektivave. Treguesit e performancës janë përdorur si mjet matës i pozicionimit të KSHK-së. Në plotësimin e objektivave të pasqyruara në PBA-në e sipërpërmendur, duke përdorur me efikasitet dhe eficiency burimet financiare dhe njerëzore, Grupi i Menaxhimit Strategjik, ka ndjekur hap pas hapi, ecurinë e realizimit të objektivave dhe përdorimin e fondeve përkatëse të destinuar për to, duke dhënë rekomandimet e rastit, duke korigjuar dhe rialokuar fondet dhe duke ndërhyrë, në rast mangësish, për të realizuar arritjen e objektivave.

Akordimi i fondit buxhetor bën të mundur realizimin e objektivave. Për vitin 2022, KSHK-së i janë akorduar 135,960 mijë lekë. Me Aktin Normativ nr. 3, datë 12.3.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021, “Për Buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, buxheti u pakësua në rreth 10% ose në shumën 1,256,875 lekë nga Zëri “Shpenzime operative”. Gjatë këtij viti, për kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve u bë transferimi i fondit nga Art. 602, tek artikulli

Bulevardi Zogu I, Nd. 9, H. 4, Ap. 7, 1016, Tiranë; Tel +355042227131;
e-mail: komitetishk@kshk.gov.al

600 dhe 601. Fondet e akorduara me ndryshimet gjatë vitit, për funksionimin e aktivitetit të KSHK-së janë në total në vlerën 134,703 (në mijë lekë), me paraqitjen strukturore të pasqyruara më poshtë. Gjatë vitit 2022, një pjesë e fondeve të parashikuara për aktivitetet jashtë vendit, nuk janë përdorur; kjo, për arsye të mosrealizimit të këtyre veprimtarive nga faktorë të jashtëm që erdhën nga homologët e vendeve fqinje. Këto aktivitete janë parashikuar të realizohen gjatë vitit 2023.


**Tabela e buxhetit të miratuar sipas zërave ekonomikë,
për vitin 2022.**

Art.	EMËRTIMI	BUXHETI VJETOR (Plani fillestar viti 2022) (në 000/lekë)	BUXHETI VJETOR (Plani i rishikuar viti 2022) (në 000/lekë)	BUXHETI VJETOR (Plani përfundimtar viti 2022) (në 000/lekë)
600	Paga	10,512	10,249	10,429
601	Sigurime shoqërore	1,743	1,699	1,744
602	Mallra e shërbime të tjera	9,505	8,555	8,330
604	Transferta Korente të Brendshme	113,000	113,000	113,000
231	Llog 231 Investime	1,000	1,000	1,000
Totali		135,760	134,503	134,503
606	Fondi i vecantë	200	200	200
Totali+ fondi i vecantë		135,960	134,703	134.703

**Tabela e realizimit të buxhetit sipas zërave ekonomikë,
për vitin 2022.**

SHPENZIME PERSONELI (Lekë)	Buxheti Vjetor (Plati i periudhës/progresiv (në000/lekë)	Fakti i periudhës/ progresiv (në 000/lekë)	PËRQINDJA (%)
Zëri ekonomik 600 (PAGAT)	10,429	10,416	99%
Zëri ekonomik 601 (SIGURIMET SHËND. dhe SHOQ.)	1,744	1,738	99%
Zëri ekonomik 602 (MALLRA dhe SHËRBIME)	8,330	3805	46%
Zëri ekonomik 604 (TRANSFERTA me të TRETË)	113,000	113,000	100%
Zëri ekonomik 606 (Transferta tek individë)	200	0	0
Zëri ekonomik 231 (INVESTIME)	1000	800	80%

GRAFIKU I REALIZIMIT TË ZËRAVE EKONOMIKË për vitet 2022/2021



Bulevardi Zogu I, Nd. 9, H. 4, Ap. 7, 1016, Tiranë; Tel +355042227131;
 e-mail: komitetishk@kshk.gov.al

GRAFIKU KRAHASUES I REALIZIMIT NË (%) për vitet 2021/2022




TABELA E REALIZIMIT TË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2022

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Lloji i Procedures së Prokurimit	Vlera e kontratës	Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	NIPT i Operatorit Ekonomik
1	Bileta transporti ajror ndërkombëtar	800,000	Purchase Tickets	65080	11-05-22	SPIRIT TRAVEL & TOURS	L32403002P
				50073	16-11-22	SPIRIT TRAVEL & TOURS	L32403002P
2	Blerje kancelarie	100,000	Small Value	50000	19-09-22	LIBRARI DYRRAHU	L91418502J
3	BLERJE DOSJE ME KUTI PER ARKIVIN	270,000	(Marreveshje e kuader) Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	259665	01-12-22	Adel CO SHPK	L22117021M

Bulevardi Zogu I, Nd. 9, H. 4, Ap. 7, 1016, Tiranë; Tel +355042227131;
e-mail: komitetishk@kshk.gov.al

4	Blerje Karburanti	#####	Small Value	200000	18-10-22	"GEGA CENTER GKG"	K66801001T
				448000	09-03-22	A&T	L32320008H
5	Blerje pajisje kompjuterike	666,666	Small Value	499300	19-10-22	EURO INFORM	K33721008C
6	Blerje pajisje zyre	83,333		83333	09-11-22	A & A SECURITY SURVEY	K31915018E
7	Blerje toner për printer dhe fotokopje	100,000		77400	29-04-22	InfoSoft Office	J62426002Q
8	Frunizim vendosje porte dhe zgare hekuri	83,333		83333	03-11-22	Robert Myrta	L52102154O
9	Materiale pastrimi, dizinfektimin dhe mjete mbrojtëse nga Covid	100,000		50600	01-06-22	S.L.M.	K71605001B
10	Mbushje e fikseve te zjarrit	16,666		6000	30-11-22	Vjollca Logu	L71406037B
11	Prodhim vule për institucionin	4,000		2500	06-04-22	ETLEVA MAZREKU	K31525172T
12	Riparim xhamash për automjetin.	19,167		19167	27-12-22	Vol-AI Service	K91313048D
	Shërbim karrotreci	29,167		29167	14-09-22	ALEKSANDER MAHMUTI	K89011501O
13	Riparime dhe mirëmbajtje të automjetit të institucionit	375,000	Small Value	160000	07-07-22	Vol-AI Service	K91313048D
				23800	17-03-22	LUXODE STUDIO	L61415029I
				100000	28-06-22	NOVAAKTI	L91806016Q

Bulevardi Zogu I, Nd. 9, H. 4, Ap. 7, 1016, Tiranë; Tel +355042227131;
e-mail: komitetishk@kshk.gov.al

				13900	14-02-22	NOVAAKTI	L91806016Q
14	Shërbim larje makine	100,000		42500	25-02-22	VIKTOR KOLA	M01722017B
15	Shërbime mirëmbajtje pajisje zyre	100,000		1010	28-02-22	Host.AL	L82309007S
				20000	30-11-22	INFOSOFT SOFTËARE DEVELOPE R	K31418036C
16	Shërbime mirëmbajtjeje (periodike) të automjetit	100,000		5000	04-07-22	Stefan Fetahu	M11809021O
				11583	26-09-22	Vol-AI Service	K91313048D
17	Shërbime pastrimi për zyrat e KSHK	208,333	Small Value	175000	13-01-22	AIR	L51712008C
18	Shërbime printimi	100,000		4000	28-06-22	ERMIR PETANAJ	K71616042A
				22500	21-12-22	ERMIR PETANAJ	K71616042A
19	Sigurimi i mjetit të transportit	100,000		27120	07-12-22	EUROSIG SHA	K41926801Ë

Konkluzione

Viti 2022 ka shënuar vazhdimësinë e misionit institucional të KSHK-së. Objektivat e synuara gjatë këtij viti, kanë arritur pritshmërinë e tyre.

Projektet e ndërmarra nga institucioni për të rritur ndjeshmërinë ndaj problemeve sociale dhe për të forcuar bashkëpunimin e mëtejshëm ndërmjet shtetit dhe organizmave fetarë në vend si një mundësi reale në kontributin që ato japin cdo ditë për shoqërinë, është misioni dhe objektivi ynë kryesor.

Efiçienca institucionale, në forcimin e mëtejshëm nëpërmjet ndërmarrjes së iniciativave konkrete të bashkëpunimit ndërinstitutional dhe në vazhdimin e misionit të zgjerimit dhe të promovimit ndërkombëtarisht të harmonisë fetare si një vlerë e shtuar në vend, është një tjetër mision yni.

Bulevardi Zogu I, Nd. 9, H. 4, Ap. 7, 1016, Tiranë; Tel +355042227131;
e-mail: komitetishk@kshk.gov.al